



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:142229
Datë: 29.03.2024
Numri i dokumentit: 05528359

Ac.nr.6193/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, nga gjyqtaren individuale Hunaida Pasuli, në çështjen përmbartimore të kreditores Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a. (KESco), Bulevardi Bill Klinton, Nr.5, Ndërtesa Elektrokosova, Kati II, Prishtinë, ndaj debitorit A.C. nga fshati Komuna e Gjilanit, duke vendosur lidhur me ankesën e autorizuarit të debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, CPK.nr.134/22, të datës 25.07.2022, më 25.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Aprovohet si e themeltë ankesa e debitorit, A.C. nga fshati Komuna e Gjilanit, ANULOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, CPK.nr.134/22, i datës 25.07.2022 dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në procedim të serishëm.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm me aktvendimin e ankimuar CPK.nr.134/22, të datës 25.07.2022, në pikën I, të dispozitivit e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e datës 01.07.2021 të debitorit A.C., të paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.443/222 të datës 22.06.2021, të Përmbartuesit Privat K.M. nga Gjilani dhe i njëjti urdhër mbetet në fuqi. Në pikën II, të dispozitivit ka vendosur që në rast të paraqitjes të ankesës kundër këtij aktvendimi, obligohet debitori A.C. që të deponojë shumën e të hollave në lartësi prej 173

€, në emër të garancisë. Nëse pala ankuese dështon ta paguajë shumën e garancisë të caktuar nga gjykata, ankesa konsiderohet se nuk është dorëzuar fare në gjykatë.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka parashtruar ankesë debitori, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përbarimore, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, të aprovoj ankesën e debitorit si të bazuar dhe të anuloj aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë ashtu që lënda t'i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe vendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka pasur.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, ashtu që në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, gjeti se

Ankesa e debitorit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditorja ka paraqitur propozim për përbarim ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm, dhe atë ekstraktit nga librat e afariste....., lidhur me borxhin e krijuar për konsumin e energjisë elektrike në vlerë prej 1,738.28 €, për periudhën kohore nga data 04.12.2013 e deri me datë 14.05.2022.

Përbaruesi Privat K.M., me urdhrin përbarimor P.nr.443/22, të datës 22.06.2022, e ka lejuar përbarimin sipas propozimit të kreditores. Kundër urdhrin për përbarim, debitori ka ushtruar prapësim me datë 01.07.2022, ndërsa kreditorja ka ushtruar përgjigje në prapësim me datë 07.07.2022. Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes në prapësim, me aktvendimin e atakuar CPK.nr.134/22, të datës 25.07.2022, ka vendosur që ta refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin mbi lejimin e përbarimit P.nr.443/22 të datës 22.06.2021, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve të palëve, ka vërtetuar se prapësimi i debitorit është i pabazuar, pasi që me rastin kryerjes së pagesës me datë 03.06.2021, në vlerë prej 40 Euro, duke e përshkruar pagesën e tij vetëm si “ pagesë e energjisë eklektike “, e jo duke e paguar secilën faturë veç e veç, e ka ndërprerë parashkrimin bazuar në nenin 368.1 dhe 2 të LMD. “Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin. Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e kështit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit “, ndërkaq me nenin 373 të LMD parashihet se “ Pas ndërprerjes parashkrimi fillon të rrjedhë përsëri, kurse koha që ka kaluar para ndërprerjes nuk llogaritet në afatin e caktuar ligjor për parashkrim, kurse par. 2 të të njëjtit nen “Parashkrimi i

ndërprerë me anë të pranimit (pohimit) nga ana e debitorit fillon të rrjedhë përsëri nga pranimi (pohimi)". Prandaj, për këto arsye nuk kemi parashkrim të borxhit sepse propozimi për përmbartim është paraqitur me datë 22.06.2022, ndërsa pagesa në fjalë është bërë me datë 03.06.2021, lidhur me pjesën tjetër të detyrimit pas datës 03.06.2021 deri me 14.05.2022, gjykata konsideron se kërkesat janë bërë të arritshme edhe nuk ka parashkrim lidhur me to, bazuar në nenin 360 të LMD par.1 pika 1.1 "Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti 1.1. kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiak" dhe par.2 " Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë." Ka shtuar se lidhur me pretendimin se dokumenti mbi bazën e së cilit është iniciuar procedura nuk është dokument i besueshëm, për shkak se nuk i përmban faturat dhe nuk është i vulosur në të gjitha faqet, gjykata gjeti një pretendim të tillë të paqëndrueshëm, bazuar në nenin 29 par 1 pika 1.2 "Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokumenti i besueshëm, sipas këtij ligji është ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave;" dhe par.3 "Dokumentet e besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit monetar", ku nga këto dispozita ligjore, arrihet në përfundim se nuk është e detyrueshme që ekstraktet e verifikuara të jenë të vulosura në të gjitha faqet, aq më pak të kenë të bashkëngjitur faturën, për shkak se fatura është njëra prej dokumenteve të besueshme të cilat i njeh LPP-ja. Meqenëse nuk janë plotësuar asnjë nga kushtet e parapara në nenin 71 të LPP-së dhe për arsyet e cekura më lartë, gjykata vendosi që ta refuzoj prapësimin dhe ta lë në fuqi urdhrin përmbartimor.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar neneve 5, 29 paragraf 1, pika 1.2, 71, 73 dhe 78 paragraf 1 dhe 2 të LPP-së, lidhur me 360 paragraf 1.1 dhe 2, 368 paragraf 1 dhe 2 dhe 373 të LMD-së.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë sipas aktvendimit të atakuar, Gjykata e Apelit nuk mund ta pranojë si të rregullt dhe të ligjshëm, për shkak se aktvendimi i atakuar është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.1 lidhur me nenin 160 dhe 175 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), si dhe lidhur me nenin 4, 17, 21, 29, 37, 38 paragraf 1 dhe 2, 43 dhe 73 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore (LPP).

Aktvendimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1, e lidhur me nenin 160 dhe 175 të LPK-së, sepse dispozitivi i aktvendimit është në kundërtënie me arsyet e aktvendimit dhe për faktet vendimtare, aktvendimi nuk përmban arsye për mënyrën e vendosjes. Gjykata ka dështuar të jep arsye për pretendimet e palës ankuese të paraqitura në prapësim lidhur me parashkrimin e kërkesës. Gjykata për pretendimin e parashkrimit ka dhënë një shpjegim të përgjithshëm pa u lëshuar në arsye konkrete se pse gjykata ka vlerësuar se duhet të zbatohen dispozitat e neni 368 pika 1 dhe 2 të LMD-së. Në këtë rast gjykata e shkallës së parë nuk i është përmbartur dispozitave

të cituara për arsyetimin e aktvendimit sepse nuk ka paraqitur në mënyrë të strukturuar dhe të kuptueshme cilat kanë qenë kërkesat e palëve respektivisht kundërshtimet, cilat kanë qenë faktet vendimtare, cilat prova janë shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe si janë vlerësuar ato dhe si pasojë ka dështuar të nxjerrë një vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Me nenin 21 të LPP-së përcaktohet se “ Organi përmbarues e cakton, e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus exexecutionis) dhe dokumentit të besueshëm po që se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”. Në kuptim të kësaj dispozite rezulton se organi përmbarues, duhet të vendos brenda kufijve të titullit përmbarues ndërsa me rastin e vendosjes për prapësimin e debitorit, gjykata është dashur të vlerësoj se a ekziston ndonjëri nga shkaqet ligjore të parapara me nenin 71 të LPP-së.

Në këtë rast duke qenë se propozimi për përmbarim është bërë në bazë të ekstraktit të verifikuar nga librat afariste dhe atë lidhur me borxhin e krijuar për konsumin e energjisë elektrike, atëherë konform nenit 360 par.1 pika.1.1 të LMD-së, në rastin konkret vlen afati 1 vjeçar i parashkrimit të kërkesës. Paragrafi 2 i nenit 360 të LMD-së, përcakton se “afati i parashkrimit fillon të rrjedhë nga fundi i vitit, në të cilin arrihen kërkesat për pagesë”, që do të thotë se nuk numërohet viti në të cilin është dashur të përmbushet kërkesa e arritur, ashtu që për kërkesat e tilla që janë krijuar gjatë vitit 2013, afati i parashkrimit do të fillojë nga 1 janari i vitit 2014 deri në ditën e fundit të vitit 2014, e kështu për çdo vit pasues. Po ashtu, me dispozitën e nenit 368 paragrafi 1 të LMD-së shprehimisht përcaktohet se “Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin”, ndërsa me paragrafin 2 përcaktohet se “Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit”. Pas shikimit të shkresave të lëndës, shihet se debitori gjatë periudhës së vitit 2013 të paraqitur në ekstraktin e verifikuar nga librat afaristë si dhe gjatë vitit 2014, nuk ka realizuar asnjë pagesë, ashtu që në kuptim të dispozitave të lartcekura ka arritur afati i parashkrimit për borxhin e krijuar gjatë vitit 2013, andaj duke qenë se i njëjti nga provat në dispozicion rezulton se nuk është kërkuar në kohën e përcaktuar ligjore, gjegjësisht kreditori nuk ka kërkuar mbrojtje gjyqësore deri në momentin e dorëzimit të propozimit me datë 22.06.2022, andaj gjykata nuk mund të ofrojë mbrojtje ligjore duke e obliguar debitorin për përmbushjen e kësaj pjese të detyrimit.

Ndërsa, gjithmonë duke iu referuar dispozitave të lartcekura, meqenëse lidhur me borxhin e krijuar gjatë vitit 2021, afati i parashkrimit do të fillojë të rrjedhë nga fillimi i vitit 2022 deri në ditën e fundit të vitit 2022 e kështu për vitet pasuese, atëherë duke qenë se sipas shkresave të lëndës del se debitori ka realizuar një pagesë të borxhit me datën 03.06.2021 në shumën prej 40 €, që nënkupton që është pagesë e shpenzimit mujor të energjisë elektrike, por duke mos e paguar borxhin në tërësi, arrihet në përfundimin se kjo pagesë ka rezultuar me pranimin e borxhit nga ana e debitorit dhe rrjedhimisht edhe me ndërprerjen e parashkrimit. Andaj, nga sa u tha më lartë, borxhi i krijuar nga viti 2021 deri me datë 14.05.2022, është borxh i cili nuk është parashkruar dhe si të tillë debitori obligohet që këtë pjesë të borxhit të ia paguajë kreditorit në emër të shërbimeve energjisë elektrike të ofruara nga kreditori.

Të gjeturat dhe konstatimet e bëra si më lartë nga gjykata ankimore, aktvendimin e atakuar e bëjnë jo të drejtë dhe pa mbështetje në ligj, me çka si i tillë u dashtë që të anulohet dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë, në rishqyrtim dhe vendosje.

Ne riprocedurë, gjykata e shkallës së parë në kuptim të të gjeturave dhe konstatimeve të bëra si më lartë nga Gjykata e Apelit e Kosovës, udhëzohet që të bëjë eliminimin e shkeljeve të dispozitave të procedurës përmbartimore në pajtim me vërejtjet e paraqitura, ashtu që të shqyrtoj prapësimin duke vlerësuar se a janë plotësuar kushtet për lejimin e përmbartimit, në rast se vlerëson se nuk janë plotësuar prezumimet procedurale për lejimin e përmbartimit, atëherë të veprojë në pajtim me dispozitat e LPP-së, për vendosjen sipas prapësimi kur prapësimi është i bazuar, përkatësisht nëse ekzistojnë shkaqet e prapësimi, duke mos përjashtuar edhe mundësinë e dëgjimit të palëve dhe varësisht nga të gjeturat edhe të vendos në këtë çështje përmbartimore, që pastaj përmes vërtetimit të drejtë të fakteve duke aplikuar dhe zbatuar dispozitat të së drejtës materiale, të ketë mundësi që në mënyrë të drejtë dhe objektive të vlerësoj çështjen e parashkrimit të kërkesës së kreditorit sipas prapësimi të bërë nga debitori, të vërtetojë faktin e arritjes së secilës kërkesë sipas dorëzimit të faturave dhe varësisht nga pranimi i secilës faturë, të llogarisë edhe afatin e parashkrimit të kërkesës, duke sjellë një vendim të drejtë i cili do të ketë mbështetje të plotë në shkresat lëndore dhe në ligj, duke pasur parasysh gjithashtu që me rastin e vendosjes meritorë, pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitohet shkeljet procedurale të konstatuara si më lartë nga gjykata ankimore, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore siç përcaktohet me dispozitën e nenit 160, e lidhur me nenin 175 të LPK-së.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në nenin 3 paragraf 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me nenin 194, 208, 209 paragrafi 1 pika d) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
Ac.nr.6193/22, më 25.03.2024

Gjyqtarja,
Hunaida Pasuli